



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrie
Ministry of Trade and Industry



Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e Kosovës
Generalna Direkcija za Akreditaciju Kosova
Kosovo General Accreditation Directorate

Raporti vjetor i Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës (DAK) për vitin 2017

Përmbajtja:

1.	Përshkrimi i aktiviteteve të realizuara gjatë këtij viti	2
1.2	Paraqitja tabelore e aktiviteteve të DAK	2
1.3	Paraqitja grafike e aktiviteteve të DAK gjatë vitit 2017	2
2.	Realizimi i buxhetit të DAK për vitin 2017	4
3.	Aktivitete e DAK-së për promovim të akreditimit	4
4.	Përshkrimi i projekteve me donatorët – përfitimet dhe sfidat	5
4.1	SIDA “Infrastruktura e Cilësisë në Ballkanin Perëndimor” (Quality Infrastructure for Western Balkans - QI)	5
5.	Marrëdhëniet rajonale/evropiane dhe ndërkombëtare të DAK	5
6.	Objektivat dhe Aktivitetet e DAK në të ardhmen	6
6.1	Nënshkrimi i Marrëveshjes Bilaterale (BLA) me EA (Korporatën Evropiane të Akreditimit) për laborator testues;	6
6.2	Implementimi i legjislacionit sekondar duke u bazuar në Ligjin Nr. 05/L-117 të akreditimit;	6
6.3	Angazhimi i mëtutjeshëm për përmirësimin dhe plotësimin e procedurave të DAK; dhe i të gjithë sistemit të menaxhimit në DAK me praktikën e mira të BE-së;	7
6.4	Zgjerimi i aktiviteteve në fusha të reja të akreditimit ;	7
6.5	Ngritjen e nivelit të kompetencës së stafit të DAK dhe ekspertëve të jashtëm;	7
6.6	Përmirësimin e bashkëpunimit me palët e interesit;	7
6.7	Promovim i vazhdueshëm i rëndësisë së akreditimit në infrastrukturën e cilësisë.	7
7.	Ngecjet në realizimin e aktiviteteve konkrete të planifikuara në Planin e Punës	7
8.	Sfidat e DAK-së	8

1. Përshkrimi i aktiviteteve të realizuara gjatë këtij viti

Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e Kosovës (DAK) arriti që me sukses të përfundoj 2017 edhe përkundër shumë sfidave që pati.

Edhe këtë vite bazuar në procedurën e vlerësimit, DAK ka vazhduar me vlerësimin e Trupave për Vlerësimin e Konformitetit. Aktivitete e akreditimit që DAK ka realizuar gjatë vitit 2017 janë si në vijim:

- 4 Akreditime (3LT, 1 LK)
- 3 Ri-akreditime (3 LT);
- 27 Mbikëqyrje të rregullta (22 Laborator Testues dhe 5 Trupa Inspektues);
- 10 Vlerësime (10 Laborator Testues);
- 1 Pezullim (LT)
- 2 Tërheqje
- 13 Aplikime për akreditim (12 LT dhe 1 TI);
- 1 Aplikime për riakreditim (TI)
- Në procedurë për ri-akreditim janë katër laboratorë testues, një kalibrues dhe një trup inspektues.


1.2 Paraqitja tabelore e aktiviteteve të DAK

Tab.1


Akreditime (LT+LK)	4
Akreditime (LT)	3
Akreditime (LK)	1
Ri-akreditime (LT)	3
Mbikëqyrje (LT)	22
Mbikëqyrje (TI)	5
Pezullim (LT)	1
Tërheqje (TI)	2
Vlerësime të TVK-ve (LT)	10
Aplikime për Akreditim (12 LT dhe 1TI)	13
Aplikime për Riakreditim (TI)	1

1.3 Paraqitja grafike e aktiviteteve të DAK gjatë vitit 2017

Tab.2



Tab.3



2. Realizimi i buxhetit të DAK për vitin 2017

Buxheti i aprovuar i DAK-së për vitin 2017 ka qenë 77,174.00 dhe realizimi gjatë këtij viti arriti përqindjen prej 92%. Nderkaq, të hyrat e realizuara nga shërbimet e akreditimit gjatë vitit 2017 kanë qenë 20.405,00 euro.

Kategoritë ekonomike	Buxheti
Paga dhe mëditje	53,693.00 €
Mallra dhe shërbime:	23,481.00 €
Shpenzime të udhëtimit	12,976.00 €
Shpenzimet për internet	1,000.00 €
Shpenzime për anëtarësim	6,250.00 €
Shërb. e nd. Intel. dhe kesh.	1,200.00 €
Botimet e publikimeve	1,000.00 €
Dreka zyrtare	1,055.00 €

3. Aktivitete e DAK-së për promovim të akreditimit

Sikurse çdo vit tjetër edhe këtë vit DAK më 9 Qershor ka organizuar Ditën Botërore të Akreditimit me qëllim të promovimit të rëndësisë së akreditimit. Moto e këtij takimi ishte: “Dhënia e besimit sektorit të ndërtimit dhe mjedisit ndërtimor”.

Në këtë manifestim morën pjesë përfaqësues të TVK-ve, Këshillit të Akreditimit, Këshillit Profesional, dhe Infrastrukturës së Cilësisë (Industria, Standardizimi dhe Metrologjia).

Gjatë takimit u mbajtën prezantimet e parapara dhe u prezantua video e përgatitur nga IAF dhe ILAC dhe e përshtatur nga DAK. Përfaqësues të DAK paraqitën të arriturat e DAK si dhe bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar të DAK. Pas prezantimeve pati diskutime të frytshme të cilat DAK-ut do të i shërbejnë si udhërrëfyes për punën e mëtejshme.

Në fund të këtij solemniteti u ndanë edhe certifikata të akreditimit për laboratorë testues dhe trupat inspektues të akredituar brenda vitit.

4. Përshkrimi i projekteve me donatorët – përfitimet dhe sfidat

4.1 SIDA “Infrastruktura e Cilësisë në Ballkanin Perëndimor” (Quality Infrastructure for Western Balkans - QI)

Gjatë vitit 2017 DAK është mbështetur vetëm nga projekti SIDA “Infrastruktura e Cilësisë në Ballkanin Perëndimor” (Quality Infrastructure for Western Balkans - QI), dhe me përkrahjen e këtij projekti zyrtarët e DAK nga data 21-22/02/2017 kanë marr pjesë në punëtorinë: Rregullorja e BE-së 305/2011 CPR – Vlerësimi i Konformitetit /Regulation 305/2011: CPR – Conformity Assessment.

Po nga ky projekt ka qenë i mbështetur edhe trajnimi i vlerësuesve/ekspertëve të trupave kombëtare akredituese, për akreditimin për qëllime notifikimi. Ky trajnim ishte dy ditorë (9-10/10/2017) dhe u realizua në Berlin. Gjatë këtij trajnimi pati dy prezantime të rëndësishme nga ekspertët e institutit gjerman për standarde DIN (DIN Deutsches Institut für Normung) Prof. Dr. Kurt Ziegler si dhe Prof. Dr. Michael Ottmann (ZLS).

Duke qenë se buxheti i DAK-së është mjaft i vogël, për DAK edhe me tutje mbetet si sfide trajnimi i mirëfilltë i stafit. Gjatë vitit 2017 përkrahja nga projektet ka qenë jo e mjaftueshme, sidomos për çështje që lidhen direkt me akreditimin. Gjithashtu sfidë për DAK është edhe trajnimi i stafit në strandardet e rishikuar ISO/IEC 17011 dhe ISO/IEC 17025.

5. Marrëdhëniet rajonale/evropiane dhe ndërkombëtare të DAK

DAK, vazhdon të ketë marrëdhënie bashkëpunimi me të gjitha Trupat Akreditues të vendeve të rajonit.

Edhe gjatë vitit 2017 përfaqësues të DAK-së kanë marr pjese në takime të ndryshme të EA-së (Kooperimi Evropian i Akreditimit) dhe atë në takimin e Këshillit për marrëveshje multilaterale të EA-së (European co-operation for Accreditation-Multilateral Agreement Council- EA MAC), i cili takim u mbajt më datë 26-27/05/2017 në Sofia-Bullgari. Gjithashtu përfaqësuesi i DAK ka marr pjesë në dy takime të Asamblesë Gjenerale. Takimi i parë u mbajt më datë 23-24.05.2017 në Bled të Sllovenisë ndërkaq takimi i dyte u mbajt në Berlin të Gjermanisë më datë 22-23 Nëntor 2017.

Ndërkaq në Pragë u organizua takimi i Komitetit për Komunikim dhe Publikim dhe në këtë takim u diskutuan çështje të ndryshme si: Strategjia e EA-së 2018-2020 dhe implementimi e saj, Dita botërore e akreditimit (WAD 2017), statistikat e ueb faqes së EA-së, raporti i ri etj. Gjithashtu në

këtë takim u diskutua edhe lidhur me aktivitetet të zhvilluara kohës së fundit, si dhe u përmend përditësimi i dokumentit EA-1/14.

DAK vazhdon të jetë anëtare shok me ILAC (International Laboratory Accreditation Co-operation), Anëtare e IAF (International Accreditation Forum), dhe anëtare shok me EA (European co-operation for Accreditation). Gjithashtu DAK vazhdon këtë marrëveshje bashkëpunimi (MoU) me Trupat Akreditues rajonal:

- MoU-n me Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit (DPA) nga Republika e Shqipërisë
- MoU-n me Institutin e Akreditimit të Maqedonisë (IARM)
- MoU-n me Agjencinë Turke të Akreditimit (TURKAK)
- MoU-n me Agjencia Kroate të Akreditimit (HAA),
- MoU-n me Trupin Akreditues të Rumanisë (RENAR)

6. Objektivat dhe Aktivitetet e DAK në të ardhmen

Në përputhje me objektivat strategjike dhe politiken e cilësisë, aktivitetet e DAK-së për vitet e ardhshme do të jenë të fokusuar në:

6.1 Nënshkrimi i Marrëveshjes Bilaterale (BLA) me EA (Korporatën Evropiane të Akreditimit) për laborator testues

Një ndër objektivat më me prioritet të DAK-së është nënshkrimi i BLA me EA. Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje do jetë i mundur vetëm atëherë kur DAK të eliminon të gjitha jokonformitetet e dhëna nga ekipi vlerësues i EA-së. Njëri prej këtyre jokonformitetëve është dhe strukturimi i DAK-së, andaj DAK përveç se ka bërë rishikimin e Sistemit të Menaxhimit, ajo po synon që sa më parë të plotësoj sktruktura e saj, të vazhdoj të mirëmbaj dhe kontrolloj Sistemin e Menaxhimit në mënyrë që në nëntor të vitit 2018, DAK të arrij të nënshkruaj marrëveshjen BLA me EA.

6.2 Implementimi i legjislacionit sekondar duke u bazuar në Ligjin Nr. 05/L-117 të akreditimit

Objektiv tjetër e DAK është që të implementoj legjislacionit sekondar si: Rregulloren e Këshillit të Akreditimit dhe Rregulloren e Këshillit Profesional. Gjithashtu DAK do të implementoj: Udhëzimin Administrativ për caktimin e formës, përmbajtjes dhe përdorimin e logos së DAK dhe simbolit të akreditimit dhe Udhëzimin Administrativ për tarifat e akreditimit.

6.3 Angazhimi i mëtutjeshëm për përmirësimin dhe plotësimin e procedurave të DAK; dhe i të gjithë sistemit të menaxhimit në DAK me praktikatat e mira të BE-së

Sistemi i Menaxhimit i DAK-së është i ngritur në bazë të kërkesave të Standardit ISO/IEC 17011 dhe duke qenë se ky standard është rishikuar dhe nga dhjetori i vitit 2017 është në fuqi versioni i ri, DAK si objektive ka që të bëjë rishikimin e sistemit të menaxhimit (SM) sipas kërkesave të standardit të rishikuar, me këtë rast DAK do të rishikoj procedurën e akreditimit të DAK si dhe të gjitha dokumente të tjera të SM.

6.4 Zgjerimi i aktiviteteve në fusha të reja të akreditimit

Sa i përket zgjerimi i aktiviteteve në fusha të reja të akreditimit si objektive të DAK për vitin 2018 është zgjerimi i fushës për akreditimin e laboratorëve mjekësor si dhe trupave certifikues.

6.5 Ngritjen e nivelit të kompetencës së stafit të DAK dhe ekspertëve të jashtëm

Me qëllim të mirëmbajtjes së sistemit të menaxhimit dhe në mënyrë që të ketë staf kompetent, DAK në planin e punës çdo vit planifikon pjesëmarrjen e stafit dhe ekspertëve të jashtëm në trajnime të ndryshme.

6.6 Përmirësimin e bashkëpunimit me palët e interesit

Në sajë të mbajtjes së takimeve si dhe ofrimit të informacioneve të ndryshme lidhur me akreditimin, DAK synon që të bëjë përmirësimin e bashkëpunimit me palët e interesit.

6.7 Promovim i vazhdueshëm i rëndësisë së akreditimit në infrastrukturën e cilësisë

Me qëllim të promovimit të rëndësisë së akreditimit DAK si objektive ka që çdo vit të organizoj takime të ndryshme me palët e interesit. Një ndër aktivitetet e DAK-së për promovim të rëndësisë së akreditimit është organizimi i Ditës Botërore të Akreditimit, botimi i broshurave, fletëpalosjeve të cilat përmbajnë informacione lidhur me akreditimin

7. Ngecjet në realizimin e aktiviteteve konkrete të planifikuara në Planin e Punës

- Edhe pse më datë 30.11.2016 është miratuar në kuvend Ligji Nr. 05/L-117 i akreditimit, DAK nuk ka arritur që të fillojmë me implementimin e legjislacionit sekondar pasi që ende nuk është bërë nënshkrimi i Rregullores për Këshillin Profesional si dhe nuk janë nënshkruar Udhëzimet Administrative: Udhëzimi Administrativ për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Akreditimit të Kosovës, Udhëzim Administrativ për caktimin e formës,

përmbytjes dhe përdorimin e emblemës së akreditimit, Udhëzim Administrativ për caktimin e tarifave për akreditim);

- Nuk është kryer plotësisht databaza për akreditimin e TVK-ve “online”;
- Nuk është përzgjedhur Drejtori i Përgjithshëm i DAK (Nga 06.06.2016 DAK ende është me UD);
- Nuk është plotësuar stafi i DAK.

8. Sfidat e DAK-së

8.1 Zgjedhja e Drejtorit të Përgjithshëm të DAK;

8.2 Miratimi i strukturës organizative të DAK sipas kërkesave të standardit SK ISO/IEC 17011 dhe Ligjit Nr. 05/L-117 akreditim, të miratuar;

8.3 Rritja e kompetencës teknike të TVK-ve;

8.4 Sigurimi i ekspertëve nga jashtë për Vlerësimin i TVK-ve dhe pagesa e tyre nëpërmjet buxhetit të DAK;

8.5 Numri i vogël i stafit (angazhimi edhe i së paku dy zyrtarëve në DAK).

8.6 Nënshkrimi i Marrëveshjes Bilaterale (BLA) me EA (Korporatën Evropiane të Akreditimit) për laborator testues;